



Në bazë të nenit 10 të Ligjit NR.05/L-120 për Trepçën, Neni 12 të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe nenin 21 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 lidhur me nenein 22 paragrafi 3 i Statutit të Trepça Sh.A, neni 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullores për marrdhënie pune të Trepça Sh.A, Kryeshefi Ekzekutiv i Trepça Sh.A, me datën 20.05.2026, merr këtë:

### V E N D I M

1. **Anulohet** konkursi publik me nr.prot.3390 të dt.21.04.2026 për pozitën Agjuntator.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Duke u bazuar në procesverbalin e komisionit të përzgjedhjes me nr.prot.3505 të dt.24.04.2026, në të cilin është konstatuar se kanë aplikuar gjashtë (6) kandidatë prej të cilëve pesë (5) nuk i plotësojnë kriteret e konkursit, andaj bazuar në nenin 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Rregullores për marrdhënie pune në Trepça Sh.A ku thuhet se “Konkursi publik duhet të përsëritet nëse së paku tre kandidat nuk i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs”, andaj Kryeshefi Ekzekutiv vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Trepça Sh.A  
Kryeshefi Ekzekutiv  
  
Faton Ahmeti  


**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj kontest pune brenda 30 ditëve nga data e pranimit.

Me këtë vendim të njoftohen:

- Anëtarët e Komisionit
- Arkivi i Trepça Sh.A.